



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 23 (827721)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 Qershor 2021

“Dita e Vëzhguesve” në Poligonin Kombëtar të Bizës



Përfundon stërvitja “Immediate Response 21”, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 21”

Në përfundim të stërvitjes “Immediate Response 21”, pjesë e paketës së stërvitjes “Defender Europe 21”, efektivë të Batalionit II të Këmbësorisë kryen ditën e martë më 1 qershor 2021, demonstrime të përbashkëta me efektivët komando, Forcat Speciale dhe efektivë të Forcës Ajrore. Ky aktivitet u mbajt në kuadër

të “Ditës së Vëzhguesve”, në Poligonin kombëtar të Bizës dhe u ndoq nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Bajram Begaj, Komandanti i FT gjeneral brigade Arben Kingji, Komandantë Forcash, drejtorë të SHPPFA, si dhe Atashetë ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s, të akredituar...

» faqe 2

SHSHPPFA gjeneralmajor Bajram Begaj vizitë zyrtare dy ditore në Kosovë

Bashkëpunim për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve në fushën mbrojtjes të dy vendeve

Gjeneralmajor Bajram Begaj është pritur në Prishtinë nga Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes i Kosovës dhe gjenerallejtënant Rrahman Ramaj, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës » faqe 3



QKMBMMFA

Koncert festiv me rastin e 1 Qershorit



» faqe 7

Kolonel Timothy J. MacDonalds

Bashkëpunimi midis trupave amerikane dhe shqiptare do të vijojë

Në kuadër të stërvitjes “Defender Europe 2021”, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj priti më 26 maj, në një takim kortezie komandantin e Brigadës së 18-të të Policisë Ushtarake të Komandës së Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, kolonel Timothy J. MacDonalds. Gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij theksoi rëndësinë e stërvitjes “Defender Europe 2021” për Shqipërinë dhe rajonin, si dhe vlerësoi...



» faqe 3

Baza Ajrore e Kuçovës

Së shpejti nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s

Në Bazën Ajrore të Kuçovës, është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes ushtarake të NATO-s, “Defender Europe 21”. Së shpejti në Bazën Ajrore të Kuçovës nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s. “Defender Europe 21” nga Baza Ajrore e Kuçovës, ku është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes dhe ku së shpejti nis investimi për...

» faqe 5

STOLTENBERG - MACRON

Stoltenberg vlerëson Francën: Ne po hapim një kapitull të ri

» faqe 12

29 MAJ-7 QERSHOR 2021 NË KOPER, SLLOVENI

Anija “Oriku” P-132, niset drejt Sllovenisë, në stërvitjen “Adriatic-LivEx-2021”

» faqe 4

MEDALJA: “NATO NON ARTICLE 5 BALLKAN MEDAL”

Pjesëmarrës në mision: KFOR nderon me medalje ushtarakët e FA

» faqe 6



Në përfundim të stërvitjes “Immediate Response 21”, pjesë e paketës së stërvitjes “Defender Europe 21”, efektivë të Batalionit II të Këmbësorisë kryen ditën e martë më 1 qershor 2021, demonstrime të përbashkëta me efektivët komando, Forcat Speciale dhe efektivë të Forcës Ajrore. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të “Ditës së Vëzhguesve”, në Poligonin kombëtar të Bizës dhe u ndoq nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Bajram Begaj, Komandanti i FT gjeneral brigade Arben Kingji, Komandantë Forcash, drejtorë të SHPFA, si dhe Atashetë ushtarakë të vendeve anëtare të NATO-s, të akredituar në vendin tonë.

Në përshëndetjen e tij, gjeneralmajor Begaj pasi adresoi një falenderim të veçantë për të gjithë të pranishmit u shpreh ndër të tjera: “Sot ndodhemi këtu midis ushtarakësh, në këtë fushë-laborator të stërvitjeve, trajnimeve dhe testimeve të kapaciteteve operacionale, për të përmbyllur me sukses këtë stërvitje historike, e cila nuk do jetë e fundit për FARSH.”.

Duke e cilësuar “një model” kombinimin e efektivëve të strukturave operacionale dhe prioritare të FARSH dhe konkretisht Batalionin e dytë, trupat Komando dhe Forcat Speciale të mbështetura nga Forca Ajrore, Komanda Mbështetëse dhe elementet të Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, gjeneralmajor Begaj u shpreh se këto struktura janë krenaria dhe elita e FARSH. “Koordinimi dhe kombinimi i stërvitjeve tona të planifikuara me trupat amerikane të stërvitjes “Defender Europe 21”, ishte një avantazh i situar, privilegj dhe eksperiencë e paçmueshme. Demonstrimi i sotëm, por edhe të tjerat më përpara, na tregojnë se kur stërvitemi dhe trajnohemi së bashku, si miq, aleatë dhe partnerë, ne do të arrijmë aftësi të jashtëzakonshme.”, u shpreh gjeneralmajor Begaj.

Në përfundim të përshëndetjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj i përgëzoi të gjithë efektivat për angazhimin dhe përkushtimin e treguar, si dhe falenderoi kolegët amerikanë për bashkëpunimin, mbështetjen, gatishmërinë dhe vullnetin e treguar duke ndarë çdo eksperiencë dhe përvojë me Forcat tona të Armatosura.

Në aktivitetin përmbyllës “Dita e Vëzhguesve” të stërvitjes “Defender Europe-21”, një përshëndetje e veçantë u bë edhe nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili duke falënderuar dhe shprehur mirënjohje për gjithë mbështetjen e dhënë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA për realizimin e të gjitha detyrave në kuadër të kësaj stërvitje, theksoi ndër të tjera se: “Kjo stërvitje ishte një mundësi e artë për Forcën Tokësore në veçanti, për forcimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencës, testimin e aftësive tona koordinuese, planizuese dhe logjistike për të zhvilluar operacione luftarake të këtij niveli.”, u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

“Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake e zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria ishte vendi kryesor pritës. Rreth 28 mijë mijë trupa nga SHBA, por edhe nga vendet e tjera aleate të NATO u dislokuan në të gjithë rajonet e stërvitjes në Europën Juglindore dhe demonstuan aftësitë për të bashkëpunuar si aleatë ushtarakë.

“Dita e Vëzhguesve” në Poligonin Kombëtar të Bizës

Përfundon stërvitja “Immediate Response 21”, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 21”

U zhvilluan demonstrime të përbashkëta me efektivë të Batalionit II të Këmbësorisë, batalionit Komando, Forcave Speciale dhe Forcave Ajrore



“DEFENDER EUROPE 21”

6000 ushtarë amerikanë stërviten me homologët shqiptarë

Gjatë muajit të fundit, pothuaj 6000 ushtarë amerikanë janë stërvitur krah për krah me homologët e tyre shqiptarë. Ambasada amerikane në Tiranë postoi në rrjetet sociale disa foto të papublikuara më parë nga stërvitja ushtarake “Defender Europe 2021”, që do të vazhdojë edhe përgjatë dy javëve të ardhshme. Ambasada e SHBA-së thotë se stërvitja ka krijuar mundësi për bashkëpunim në të gjithë Shqipërinë, ku ushtarët kanë jetuar dhe kanë kryer së bashku operacione të ndryshme stërvitore. “Gjatë muajit të fundit, pothuaj 6000 ushtarë amerikanë janë stërvitur krah për krah me homologët e tyre shqiptarë. Stërvitja ka krijuar mundësi për bashkëpunim në të gjithë Shqipërinë, ku ushtarët kanë jetuar dhe kanë kryer së bashku operacione të ndryshme stërvitore”, thekson Ambasada e SHBA-së. “Stërvitja më e madhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor “Defender Europe 21” do të vazhdojë përgjatë dy javëve të ardhshme”, shkruante para pak ditësh në një postim, Ambasada Amerikane në Tiranë.



SHSHPFA gjeneralmajor Bajram Begaj vizitë zyrtare dy ditore në Kosovë

Bashkëpunim për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve në fushën mbrojtjes të dy vendeve

Gjeneralmajor Bajram Begaj është pritur në Prishtinë nga Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes i Kosovës dhe gjenerallejtënant Rrahman Ramaj, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral, ditën e mërkurë, më 2 qershor 2021, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Bajram Begaj ka nisur një vizitë zyrtare dy ditore në Kosovë. Me këtë rast, në Ministrinë e Mbrojtjes, me nderimet më të larta ushtarake, ai u prit nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Ramaj. Në fillim ai u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj ku u bisedua për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë vëllazëror me gatishmërinë e plotë për realizimin e suksesshëm të planit të përbashkët në funksion të avancimit të mëtejshëm të aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes së dy vendeve si dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Më pas, gjeneral Rama dhe gjeneral Begaj zhvilluan takimin tête-à-tête për të vazhduar në takimin në nivel të dy delegacioneve. Me këtë rast, shefi i Departamentit të Planifikimit të SHPFSK-së, kolonel Agron Bajrami ka informuar rreth Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit. Në vazhdim nga ana e gjeneral Ramës u vlerësua lart niveli i deritashëm i bashkëpunimit ushtarak, fokusi i takimit ishte angazhimi i përbashkët për realizimin e planit të përbashkët të veprimit bazuar në Marrëveshjen e re të bashkëpunimit bilateral të nënshkruar para disa ditësh në mes ministrave Mehaj dhe Peleshi. Gjatë diskutimit, gjeneral Rama e njoftoi gjeneral Begajn me zhvillimet në FSK si dhe të arriturat e deritashme, konkretisht me përfundimin e suksesshëm të operacioneve stërvitore në kuadër të "Defender-Europe 21", procesin e realizimit të Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së, pjesëmarrjen e kontingjentit të parë në operacione ushtarake jashtë vendit, si dhe procesin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë. Nga ana e tij, gjeneral Begaj tha se e gëzojnë shumë të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së duke u zotuar për një bashkëpunim edhe më të intensifikuar në të gjitha fushat me mbështetje të pa rezervë për realizimin e planit të përbashkët të bashkëpunimit si dhe objektivave të përcaktuar të FSK-së në të ardhmen.

Më pas, gjeneral Begaj, vizitoi Qendrën Mjekësore të FSK-së ku nga drejtori i saj, Dr. Shkëlzen Sylu u informua me organizimin, kushtet, ambientet, pasjisjet, stafin dhe funksionimin e Qendrës. Në fund të vizitës së ditës së parë, gjeneral Begaj i shoqëruar nga zv.ministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylu dhe zv.komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, vizitoi Qendrën për Studime Universitare të Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së ku takoi edhe kadetë-studentët e Shqipërisë që studiojnë në këtë qendër krahas njoftimit me organizimin, plan programet dhe funksionimin e saj nga ana e komandantit të QSU-së, major Ali Haxhimustafa. Vizita e gjeneral Begajt dhe delegacionit të tij ka vazhduar edhe ditën e enjte me vizita dhe takime.



Kolonel Timothy J. MacDonalds

Bashkëpunimi midis trupave amerikane dhe shqiptare do të vijojë

Gjeneralmajor Begaj priti komandantin e Brigadës së 18-të të Policisë Ushtarake të Komandës së Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, kolonel Timothy J. MacDonalds

Në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 2021", shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj priti më 26 maj, në një takim kortezie komandantin e Brigadës së 18-të të Policisë Ushtarake të Komandës së Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, kolonel Timothy J. MacDonalds.

Gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij theksoi rëndësinë e stërvitjes "Defender Europe 2021" për Shqipërinë dhe rajonin, si dhe vlerësoi kontributin e Ushtrisë së SHBA-së në rritjen e aftësive operacionale të FARSH duke falenderuar Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes të atashuar në Shqipëri. Nga ana e tij, kolonel MacDonalds, pasi vlerësoi maksimalisht performancën e treguar gjatë stërvitjes nga trupat shqiptare të Policisë Ushtarake të dislokuara në rajonin e Bazës Ajrore të Kuçovës, e siguroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH se bashkëpunimi midis trupave amerikane dhe shqiptare do të vijojë edhe përtej stërvitjes "Defender Eu-



rope 2021" në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës. Stërvitja "Defender Europe 2021", që prej fil-

limit të muajit maj vijon me intensitet të plotë fazën e ekzekutimit në të gjitha rajonet stërvitore në tokë, det dhe ajër

me pjesëmarrje të gjerë të trupave shqiptare, amerikane dhe atyre të vendeve aleate.



Në stërvitjen rajonale “Adrion-LixEx-2021” marrin pjesë personel dhe anije të Flotës Detare italiane, shqiptare, sllovene, kroate, malazeze dhe greke. Gjatë kësaj stërvitjeje efektivët e forcave detare të rajonit do të përpunojnë elementë të luftës në det në kuadër të mbrojtjes dhe sigurisë rajonale detare.

Stërvitja zhvillohet nga 29 maji deri më 7 qershor 2021 në Koper, Slloveni

Anija “Oriku” P-132, niset drejt Sllovenisë, në stërvitjen “Adrion-LivEx-2021”

Në stërvitjen rajonale “Adrion-LixEx-2021” marrin pjesë personel dhe anije të Flotës Detare italiane, shqiptare, sllovene, kroate, malazeze dhe greke

Anija “Oriku” P-132, ka mbërritur në Koper të Sllovenisë, ku krahas pesë flotave të tjera detare, po merr pjesë në stërvitjen rajonale “Adrion-LivEx-2021”, stërvitje e cila ka nisur më 29 maj dhe do të vazhdojë deri më 7 qershor 2021.

Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia mori pjesë më 29 maj 2021, në ceremoninë e përcjelljes së anijes “Oriku” P-132, në stërvitjen rajonale “Adrion-LivEx-2021”, që do të zhvillohet nga data 29 maj deri më 7 qershor 2021 në Koper, Slloveni, i cili është vendi organizator sipas rotacionit të zhvillimit të kësaj stërvitjeje për këtë vit.

Në ceremoninë e zhvilluar në Flotiljen Detare Pashaliman, morën pjesë gjithashtu zëvendëskomandanti, kapiten i rangut të I-rë Ferdinant Kreshpani, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari, efektivë të Flotiljes

si dhe ekuipazhi i anijes “Oriku”.

Në stërvitjen rajonale “Adrion-LixEx-2021” marrin pjesë personel dhe anije të Flotës Detare italiane, shqiptare, sllovene, kroate, malazeze dhe greke. Gjatë kësaj stërvitjeje efektivët e forcave detare të rajonit do të përpunojnë elementë të luftës në det në kuadër të mbrojtjes dhe

sigurisë rajonale detare.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është perfeksionimi i elementëve të Livex, Passex dhe koordinimi i veprimeve të ekuipazheve dhe anijeve pjesëmarrëse gjatë zhvillimit të operacioneve të kërkim - shpëtimit në hapësirën detare të Adriatikut e Jonit, në rajone të përbashkëta.

Qendra Stërvitore, Pashaliman



Përfundon kursi i Avancuar i Oficerit, për gradën kapitenlejtënant

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar në mjediset e Qendrës Stërvitore, Pashaliman në certifikimin e kursantëve, të cilët përfunduan kursin e Avancuar të Oficerit, për gradën kapitenlejtënant. Në ceremoni gjithashtu ka marr pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Ferdinant Kreshpani, komandanti i Qendrës Stërvitore kapiten i rangut II Bamir Likaj, si dhe personel i Qendrës Stërvitore. Kursi i Avancuar i Oficerit u zhvillua në një periudhë 12 javore, në të cilën morën pjesë shtatë oficerë. Kursantët gjatë kësaj periudhe kanë treguar disiplinë të lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Trajnimi i kursit pati kryesisht mësim teorik si njohuri mbi operacionet detare, gërshetuar këto në veprime praktike, të cilat u zhvilluan dhe në det sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare.

NË BAZËN DETARE PASHALIMAN

Përfundon aktiviteti në Qendrën Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak

Paraditen e datës 28 maj, në Bazën Detare Pashaliman u zhvillua ceremonia e mbylljes së aktivitetit të Qendrës Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (MNCC). Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Në fjalën e tij gjeneral brigade Xhebexhia duke i falënderuar kolegët e MNCC u shpreh se ka qenë kënaqësi, përgjegjësi dhe privilegj për Forcën Detare të mirëpresë MNCC në Bazën Detare të Pashalimanit. Flotilja Detare dhe MNCC përfituan nga ky rast për t'u trajnuar dhe stërvitur së bashku. Demonstrimi që u përgatit për ditën e hapur nga të dy ekipet, ku pjesëmarrës ishin ministri i Mbrojtjes dhe ambasadorët e vendeve të përfaqësuar në stërvitje, tregoi se së bashku mund të arrijmë shumë. Shqipëria është një vend i vogël, por stërvitja “Defender Europe 21” tregoi që çdo aleat dhe partner, pavarësisht madhësisë dhe kapacitetit që disponon, mund të kontribuojë për Aleancën. Shqipëria, duke



vendosur në dispozicion të stërvitjes, eksperiencën dhe njohuritë e saj mbi rajonin, si dhe kapacitetet e saj kombëtare të tilla si portet, aeroportet, bazat dhe asetet ushtarake, bëri që “Defender Europe 21” të ishte një stërvitje e suksesshme. Në fund komandanti i Forcës Detare, i uroi gjithsecilit udhëtim të mbarë për në vendet e tyre me shpresën se do të shihemi përsëri në stërvitjen “Defender

Europe 23”. Gjithashtu, komandanti i Flotiljes Detare, kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari në fjalën e tij falënderoi komandantin e MNCC-së, nënkolonel Larson për bashkëpunimin e treguar në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta stërvitore. Në përfundim të ceremonisë, kapiten i rangut të II-të Gjinollari i dhuroi nënkolonel Larsonit simbolin e Flotiljes Detare në shenjë falënderimi.

Baza Ajrore e Kuçovës, një ndër 5 qendrat e stërvitjes "Defender Europe 21"

Së shpejti nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s

Në Bazën Ajrore të Kuçovës, është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes ushtarake të NATO-s, "Defender Europe 21". Së shpejti në Bazën Ajrore të Kuçovës nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s. "Defender Europe 21" nga Baza Ajrore e Kuçovës, ku është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes dhe ku së shpejti nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s", -shkruan Kryeministri Rama.

"Qendra logjistike mbështet stërvitjen me transport, karburant, çadra, ushqim dhe çdo gjë tjetër. Në Kuçovë u instalua edhe sistemi amerikan i raketave 'Patriot'. Gjithashtu në Kuçovë policia ushtarake shqiptare dhe amerikane po zhvillojnë stërvitje të përbashkët. Rruga e rindërtuar rishtas mundëson akses më të lehtë në bazën ajrore", -thuhet në video.

"Defender Europe 21" është stërvitja më e madhe ushtarake që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Rreth 28 mijë mijë trupa nga SHBA, por edhe nga vendet e tjera, aleate të NATO, po demonstrojnë një rritje të aftësive ushtarake për të bashkëpunuar si aleatë ushtarakë.



Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse



Përfundon Kursi Bazë i Nënoficerit në katër specialitete

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit, specialiteti logjistikë/furnizim si dhe transport - mirëmbajtje dhe xhenio. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zyla, si dhe komandantët e reparteve të Komandës Mbështetëse. Në fjalën përshëndetëse shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse kolonel Çela falënderoi kursantët për rezultatet e arritura, instruktorët e tyre, si dhe një falënderim të veçantë për komandantin e Qendrës Stërvitore për punën e palodhur. Kolonel Zyla përgëzoi kursantët për angazhimin maksimal që ata dhanë për të përvetësuar njohuritë edhe i uroj atyre suksese në karrierën ushtarake. Në kurse morën pjesë 13 vetë, kursantët ishin kryesisht nga Batalioni i Xhenios. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët.

Shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse kolonel Çela falënderoi kursantët për rezultatet e arritura, instruktorët e tyre, si dhe një falënderim të veçantë për komandantin e Qendrës Stërvitore për punën e palodhur

QENDRA STËRVITORE E FORCËS AJRORE NË KUÇOVË

Përfundon Kursi Bazë i Avancuar i Nënoficerit: specialiteti "Forcë Ajrore"

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore në Kuçovë, u zhvillua më 26 maj, ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit në specialitetin "Forcë Ajrore". Në këtë aktivitet mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore major Ervin Demo, komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Olldashi, kursantët e të dy kurseve të sapo certifikuar si dhe stafi dhe instruktorë të kësaj qendre.

Kolonel Ylli Pulaj, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi nënoficerët për seriozitetin e përkushtimin e treguar gjatë kësaj faze arsimimi duke theksuar se, ky kurs institucional është i rëndësishëm jo vetëm për konkurrimin e promovimin në gradën e tatarit dhe të rreshterit, por gjithashtu përmirëson dijet profesionale të nënoficerëve të Forcës Ajrore, të cilët do të shërbejnë në teknikën ajrore si dhe hap rrugën për



ndjekjen e kurseve të tjera funksionale, që vlejnë për një karrierë më të gjatë e të merituar në Forcën Ajrore.

Më pas, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore një falënderim të veçantë adresoi për drejtuesit dhe instruktorët e Qendrës Stërvitore, të cilët me përkushtim zhvilluan programin e këtyre kurseve duke bërë të mundur

pajisjen me njohuri të përgjithshme të nënoficerëve. në specialitetet e teknikës në Forcën Ajrore.

Kolonel Pulaj në përfundim të fjalës përshëndetëse, inkurajoi stafin dhe nënoficerët të punojnë me optimizëm, kurajë dhe përkushtim për realizimin e objektivave, detyrave dhe përbashkëta.

Kapiten-Leitnant Ormeni:

Trajnimi me efektivë të SHBA-së është shumë i rëndësishëm

Kapiten-Leitnanti shqiptar i Forcës Detare, Eldi Ormeni ndihmoi në drejtimin e anijes së “Defender Europe 21”, në operacionin më të madh të stërvitjes në Ballkan që u zhvillua në vendin tonë. Si oficer ndërlidhje (LNO), është detyra e Ormenit që të sigurojë lidhjen midis personelit shumëkombësh ushtarak dhe civil të përfshirë në stërvitjet “Defender Europe 21”. Ormeni ka punuar edhe jashtë orarit të punës për të ndihmuar në lehtësimin e operacioneve logjistike në Portin e Durrësit, organizimin, koordinimin, drejtimin dhe përkthimin për personelin shqiptar, të SHBA-së dhe të MB në mënyrë që të sigurojë unitetin e përpjekjeve midis ekipeve shumëkombëshe ndërsa ato punuan së bashku gjatë operacioneve të mëdha që sollën mijëra pajisje dhe furnizime në Shqipëri.

Shqiptari është shprehur se në bordin e anijes mësoi rëndësinë e gjendjes morale dhe përpjekjet të nxisë një frymë miqësie midis trupave amerikane dhe shqiptare që jetojnë dhe punojnë së bashku këtu. “Ne jemi përpjekur të krijojmë aktivitete të ndryshme midis



forcave shqiptare dhe atyre amerikane që ata të mund të krijojnë atë marrëdhënie me njëri-tjetrin”, -tha ai. Ai shtoi se këto marrëdhënie janë të rëndësishme sepse përveç stërvitjes ku ata po fitojnë profesionalizëm, gatishmëri dhe aftësi drejtuese, si dhe zgjerojnë ndërveprimin midis kombeve partnere, ata gjithashtu po njihen me njëri-tjetrin dhe po ndërtojnë miqësi dhe besim që do të lejojë të punojnë së bashku pa probleme në misionet e ardhshme. “Ne kemi ekipin e zhytjes së Shqipërisë i cili ka bashkëpunuar me ekipin e zhytjes së ushtrisë amerikane, duke punuar së bashku dhe duke u stërvitur në ujërat tona. Ata po eksplorojnë ujërat tona dhe po ndajnë përvoja me njëri-tjetrin dhe

duke mësuar nga njëri-tjetri”, -tha Ormeni. Sipas Ormenit, komandantët shqiptarë dhe amerikanë kanë qenë shumë dakord në këto misione të përbashkëta stërvitore. “Për mua, të bëj një nga trajnimet e mia të zhytjes me zhytës të SHBA-së është shumë e rëndësishme. Kjo më bën më të sigurt dhe e di se ai do të bëjë një punë të shkëlqyer në det. Së bashku nuk na mundin dot. Ne jemi më të fortë së bashku”, -tha ai. “Defender Europe 21” është një stërvitje në shkallë të gjerë e udhëhequr nga ushtria Amerikane, e krijuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin midis SHBA-së, aleatëve të NATO-s dhe ushtrive partnere.

Medalja: “NATO non article 5 Ballkan Medal”

Pjesëmarrës në mision: KFOR nderon me medalje ushtarakët e FA

KFOR në Kosovë, ka nderuar me medaje, nënkolonel Arjan Rroshi, nënkolonel Lulzim Hoxha, kapitene Elisabeta Alcani dhe kapitene Anita Gruda

Misioni i KFOR-it në Kosovë ka nderuar me medaljen e NATO-s, “NATO non article 5 Ballkan Medal”, nënkolonel Arjan Rroshi, nënkolonel Lulzim Hoxha, kapitene Elisabeta Alcani dhe kapitene Anita Gruda, pjesë e kontigjentit aktual të Forcave të Armatosura shqiptare në KFOR. Medaljet iu dorëzuan ushtarakëve shqiptarë nga Komandanti i KFOR-it gjeneralmajor Franco Federici dhe generalbrigade Gunt-er Schopf, zëvendës komandant i misionit.

Medalja e “Jo-Artikullit 5 të NATO-s” për Shiritin e Ballkanit nderon anëtarët ushtarakë dhe civilët të cilët kryejnë shërbim në mbështetje të operacioneve të NATO-s në ose pas 1 janarit 2003 në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë tokën dhe hapësirën ajrore në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni (Ish Jugosllavi). Për të qenë të kualifikuar, individët duhet të kenë kryer 30 ditë shërbim në këtë rajon, radhazi. Çmimet e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut nderojnë anëtarët e ushtrisë ndërkombëtare që kryejnë shërbim në emër të NATO-s, pra të forcave ushtarake aleate ndërkombëtare të angazhuara për të mbështetur njëri-tjetrin në rast konflikti.

Medalja e NATO-s u krijua për herë të parë në 1996 për

të vlerësuar individët që kishin shërbyer në Forcën e Zbatimit (IFOR) si pjesë e Operacionit Përpjekje e Përbashkët në ish-Jugosllavi. Shiriti u krijua në 1999 për pjesëmarrësit në Operacionin Forca Aleate në Kosovë. Ndërsa operacionet e NATO-s u bënë më të zakonshme, shiritat të ndryshëm u krijuan për secilin operacion. Medalja përmban një trëndafil të qarkuar të përshtatur nga një kurorë dafinash. Shiritat janë blu dhe përgjysmohet nga një shirit i hollë vertikal argjendi, i rrethuar nga të dy anët, nga një shirit i hollë i bardhë.

“ Moral Welfare Activities”

Përveç detyrave operacionale në kontributin e tyre në misionin e KFOR-it, nën autoritetin operacional të Komandës të KFOR, ushtarakët ndërthurin detyrimet dhe përgjegjësitë kombëtare si ushtarakë të FA të RSH me aktivitetet dhe programet që kontribuojnë në mbajtjen, gatishmërinë dhe mirëqenien mendore, fizike dhe emocionale të personelit ushtarak. Pa u shmanjur nga detyrimet direkte të misionit dhe angazhimet kombëtare, qofshin këto lidhur me detyrat që gjithësecili ka në FARSH, qofshin edhe ato sociale që janë DMD në një mision për të ruajtur gjendjen morale psikologjike e shëndetësore të kontigjentit.



Në prag të takimit të Brukselit, më 14 qershor 2021

Shqipëria mbështet konceptin e ri strategjik "NATO 2030"

“Shqipëria mbetet e përkushtuar në garantimin e sigurisë kolektive për dekadat që do të vijnë dhe mbështet konceptin e ri strategjik të nismës NATO 2030”. Ky ka qenë mesazhi kryesor i Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka gjatë fjalës së saj në takimin e Ministrave të Jashtëm të NATO-s, mbajtur virtualisht, me 1 qershor 2021.

Ministrja Xhaçka paraqiti qëndrimet e Shqipërisë mbi çështjet e rëndësishme të vizionit NATO 2030, duke theksuar gjithashtu rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të unitetit dhe kohezionit të Aleancës. “Ka ardhur koha që qasja e NATO-s drejt Ballkanit Perëndimor të strukturohet dhe konsolidohet në një strategji të duhur të aleancës në rajon”, nënvizoi ministrja Xhaçka. Takimet e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe atyre të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, i paraprijnë përgatitjeve për takimin e nivelit të lartë të kërërve të shteteve dhe qeverive të vendeve të Aleancës, i cili do të mbahet më 14 qershor në Bruksel. Ky samit pritet të hapet një kapitull i ri në marrëdhëniet transatlantike, duke dhënë një mesazh të vendosur mbi unitetin dhe kohezionin transatlantik, si dhe të marrë vendime strategjike mbi adaptimin e NATO-s në të ardhmen.



Qendra Kulturës, Medias, Borimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA

Koncert festiv me rastin e 1 Qershorit

Parku i Liqenit të Tiranës në tingujt e këngës dhe ngjyrave të pikturave, realizuar nga fëmijët e ushtarakëve

Ditën e martë, pasdite, në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës, Qendra Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA, institucion në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes organizoi një koncert me rastin e festës së 1 Qershorit. Pranë busteve të vëllezërve Frashëri fëmijët e ushtarakëve realizuan një koncert për bashkëmoshatarët e tyre, prindërit dhe kalimtarët e shumtë të cilët u bënë pjesë e këtij programi.

Të pranishëm për të ndjekur aktivitetin ishin Zv.ministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, dhe drejtoresha e Qendres Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA, znj. Mirela Roshi. Ky aktivitet muzikor është përgatitur nga Sektori i Aktiviteteve me drejtues z. Gazment Çaçi, regjizor Saimir Braho dhe artistët Redon Makashi dhe Kozma Dushi.

Fëmijët sollën një atmosferë të hareshme nën tingujt e zërave të tyre, por jo vetëm ata nën kujdesin e specialistes së pikturës Albina Ceka kishin realizuar punime mjaftë të veçanta, të cilat në formën e një ekspozite të vogël i paraqiten për të gjithë të pranishmit.

Fëmijët ndjekin kurset e kantos, pianos, kitarës, pikturës dhe ky ishte momenti më i mirë dhe më i bukur për të treguar rezultatet e punës së tyre. Ata merituan çdo duartrokitje si të prindërve, që tregojnë se në çdo rast janë mbështetësit e tyre me besnik, por edhe të mësuesve të cilët ndihen krenar kur shikojnë se puna



e tyre jep fryte të tilla.

Zv.ministrja Bici në përshëndetjen e saj iu drejtua fëmijëve duke u thënë “Unë shoh tek ju dritë, gëzim, shpresë dhe të ardhmen. Duhet ti bëni krenarë prindërit tuaj, gjyshërit dhe kjo arrihet duke u bërë edhe më të mirë duke pasur vetëm suksese në mësim, gjë për të cilën jam e bindur se ju do ti arrini. Ishte një kënaqësi dhe ju falënderoj për secilin emocion, që na dhurovat.” Në faqen e tij zyrtarë në facebook është shprehur edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi duke thënë “Urimi i 1 qershorit nga fëmijët e talentuar të ushtarakëve për të gjithë bashkëmoshatarët e tyre. Gëzuar!”

Cirku, animatorët ishin të pranishëm për ti dhënë edhe më shumë ngjyra festës. Numrat e akrobacisë dhe humori shoqëruan shfaqjen gjatë gjithë kohës. Fëmijët meritojnë gjithë vëmendjen tone, janë e ardhmja e shoqërisë.





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Nga ushtarak në dramaturg

Bashkim Kozeli ka lindur në vitin 1942, në Ersekë. Shkollën fillore dhe uniken i kreu ne shkollën 7-vjeçare “11 Janari” në Tiranë. Pasi mbaroi Shkollën e Mesme Ushtarakë “Skënderbej”, vazhdoi studimet për pilot në ish-Bashkimin Sovjetik, por i ndërpreu ato për arësye shëndetësore. Më pas u arsimua për sinoptikant, profesion të cilin e ushtroi për disa vite si pedagog në Shkollën e Aviacionit në Vlorë. Angazhimi i tij i suksesshëm në letërsi, kryesisht në dramaturgji, bëri që në vitet në vazhdim të punonte në sektorët e kulturës dhe edukimit në radhët e ushtrisë, deri në drejtor i Drejtorisë të Edukimit të Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes gjatë viteve 1992-2000.

Për mjaft kohë ka qenë shkrimtar në profesion të lirë. Mbi dhjeta drama të Kozelit janë vënë në skenë nga teatrot profesioniste të Vlorës, Gjirokastrës, Fierit, Korçës, Shkodrës (katër prej të cilave edhe në Teatrin Kombëtar (Popullor). Ndër to mund të përmendim “Shokët” (1968), “Sinjali i kuq” (1971), “Si u kalitëm” (1974), “Lidhur si fishekë gjer-dani” (1981), “Troket historia” (1982), “Buzëqeshjet e një mbrëmjeje” (1985), “Pavdekësi” (1987), “Ustai” (1995), “Ora e mbetur” (2007), “Ëndrra e Ismail Qemalit” (2012), “Nanë Tereza kur ishte Gonxhe”, (2016). Ai është skenarist i disa filmave artistike të Kinostudios “Shqipëria e Re”, si “Në emër të lirisë” (1987), “Pas takimit të fundit” (1989), “Pleqtë e hashashit” (2010), si dhe seriali televiziv me dhjetë pjesë në RTSH “Dhimbja e dashurisë” (2009). Ai ka fituar disa herë çmime e urdhra si dhe vendin e parë në konkursat kombëtare të dramës në vendin tonë. Gjithashtu ai është autor i mjaft librave me poezi dhe shkrimeve për etikën dhe kulturën.

Tek drama gjeja ngushëllim...

Në jetën e tij, Bashkimi kaloi nëpërmjet ulje dhe ngritje, midis tensionesh dhe peripecish, ët cilat falë durimit dhe dashurisë pas dramës mundi që t’i përballojë me sukses. Për shkak të një dënimit të vëllait Begator Kozeli, i cili ishte komisar i Brigadës së Tankeve në vitin 1974, edhe Bashkimi do të ulej në detyrë dhe do të përfundonte komandant toge në një repart të largët në Vlorë. Ai Vlorën e dashuronte dhe e admironte. Edhe pse komandant toge dhe larg familjes, përsëri Bashkimi e gjente kohën të shkruante dhe të shkruante drama.

Artistët e mëdhenj Kadri Roshi dhe Sandër Prosi e kishin ndjekur nga pranë punën e tij, dhe përsëri kërkonin drama prej tij. Kështu një ditë, duke takuar Kardi Roshin në Tiranë, ai i kishte thënë se na ke prurë ndonjë dramë. Bashkimi i ishte përgjigjur, jo një por dy drama. Këto drama nën kujdesin e tyre mundën të shfaqen në qytetin e Vlorës, dhe përsëri Bashkim Kozeli do të fitonte respektin dhe admirimin e publikut vlonjat. Libri me dramatë titulluar “Tri drama” në natyrën e tyre trajtojnë probleme të ngjarjeve historike, por dhe të luftërave të bërë nga populli shqiptar. Të tri dramat përshkruajnë ngjarje luftarake dhe kanë të bëjnë me histori ushtarakë, luftën e

Krijime të autorëve ushtarakë

Bashkim Kozeli
dhe “Tri drama”

grekut në jug në vitin 1913-1914, luftën e shqiptarëve kundër italianëve në vitin 1920 dhe luftën e fundit, apo luftën për çlirimin e Kosovës në vitin 1999.

Vajza e një gjenerali

Drama “Vajza e Gjeneralit” zhvillohet në kohën kur President i Greqisë ka qenë gjenerali Pangallos. Sapo qe shpallur Pavarësia e Shqipërisë. Meqë Austria dhe Italia përkrahnin pretendimet shqiptare, grekëve ju duhej të shtinin sa më shpejt në dorë Janinën, për të përforcuar pozitën në Epir... Shqipëria e kishte Janinën kryeqendër shqiptare, dhe aty u zhvilluan luftime të përgjakshme... Pas çlirimit të Janinës, armatat greke hynë në Gjirokastrë, Tepelenë dhe sarandë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Pangallosi ishte komandant i Divizionit të tetë grek që pushtoi Shqipërinë e Jugut me pretendime Vorio-Epiriote. Në këtë pushtim ai pa me sytë e tij një realitet krejt ndryshe në tokat e pushtuara. Por, kur u bë kryeministër e President i Greqisë filloi të reflektojë dhe të mbajë tjetër qëndrim ndaj Shqipërisë fqinje. Në fillim të vitit 1926 në Gjenevë ai bëri një deklaratë zyrtare para Lidhjes së Kombeve, me të cilën Greqia njihte minoritetin shqiptar të Çamërisë në Greqi dhe se nuk i quante më myslimanet çam popullsi turke. Po ashtu deklaroi se “teza që është mbajtur nga grekët deri më sot se ortodoksët shqiptarë janë grekë është e gabuar dhe e shkëlmuar nga të gjithë. Me që ajo ka marrë të tatëpjetën dhe aritri pikën e raskapitjes, kam marrë masa të duhura, shpërndava të gjithë shoqëritë Vorio-Epiriote që mishëronin skajet më ekstreme të këtij mendimi të sëmurë”.

Homazh për këtë burrë shteti të Greqisë mike, mesazhet e të cilit janë edhe sot më se aktuale.

Në këtë atmosferë zhvillohen ngjarjet e kësaj drame, ku vajza e një gjenerali grek, e cila studion në një vend demokratik, arrin të tronditë, të shkundë dhe të triumfojë ndaj të atit me prirje ultranacionaliste dhe Vorio-Epiriote.

Edhe lufta
është një dasëm...

“Dasmë në luftë” është drama tjetër të cilën Bashkim Kozeli e ka shkruar në kujtim të aktorese së madhe Liza Laska, e cila i dha jetë kryerolit të nënës muhaxhire në këtë dramë. Një nga vendimet gjatë Luftës së Vlorës të vitit 1920, që u morr nga Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare ishte dhe ai i pajtimit të gjagjeve dhe hasmërive. Në Ditën e Flamurit burrat e këtij vatani kanë hedhur vallen në ballë të burrave, dhe Isa Boletini ju ka dhuruar një shami të kuqe me shqipinjen në mes. Ndaj dhe ne të gjithë ndoqëm shembullin e derës së kësaj shtëpie dhe u pajtuam me hasmin... me shaminë e Isa Boletinit, i pari i shtëpisë ja merr valles duke kënduar këngën “Moj Vlorë, moj Vlorë...Moj Vlorë e bukur në gropë/ Më e bu... më e bu... Më e bukura në Evropë....

Drama fillon me këngë “O burra, o djem, u bini, se na mbuloi qafiri. Në istikame t’i hidhi!”. Po a i thuhet mikut qafir, more?... Kjo është për faqe të zezë!... Prandaj, në më njëhni për patriot, hapni

veshët e më dëgjoni çfare do t’ju them: Gjithë mysafirët e tjerë që kanë ardhur këtu e kanë dashur një çikë Shqipërinë, po ky miku i sotëm na do më shumë... Këtë e kam kuptuar, kur hiqja për kapistalli në kufi karvanin e Komisionit të Fuqive të Mëdha... Gjuhën nuk ua kuptoja, po ky miku i sotëm më afronte më shumë, paqsa se atëhere doli kënga: Këta mysafirët tanë/ Shëmbëllejnë me bostanë/ Te provosh pesëmbëdhjetë/ Nuk të del një i vërtetë...

Por ja që, mysafiri i sotëm na doli i vërtetë... Dhe kur ke një mik të tillë, more vëllezër, nga të mos të të bëhet zemra mal?... Mirëpo janë ca e ca të paudhë, që u është bërë koka barut dhe kanë ngritur këngë e thonë: Piacentinin e zu frika/ Nga Selam zëmër me çika... Që bëri poshtë nga Babica... E zuri... e zuri... E zuri topin nga gryka!

Dhe historia e dramës vazhdon, kur herën e fundit që erdha nuk pata kohe të pyesja dhe të çmallesha dhe tregon vendin ku ishte ulur dikur xha Braho, një patriot. Ja, këtu plaku i Vlorës e piu një kafe. Isa Boletini i ndezi duhanin dhe mua më afroi pranë vetes dhe me shtrëngoi fort Me pëshpëriti në vesh se ajo shami e kuqe që mu dha nuk ishte shami, por flamur. Edhe herën i fundit këtu e gjeta copën e kuqe për flamur... I kish fshehur mëndafshin në torbë një plak dhe ma dha mua. Me atë ne bëmë flamujt e çetave.


Ndërsa gjeneral Piacentini nuk po i përgjigjej Ultimatumit dhe nuk besonte që katër mijë çobenj, thuaj... katër mijë

iptare bëheshin natën, sepse shqiptarët e njihnin mirë vendin e tyre, me sy mbyllur... Shqiptarët përdorin tjetër art ushtarak, që ndonëse nuk ishte i shkruar në literatur... Në sulmet e tyre ata u ngjasojnë përrënjëve, që turren e bëhen lumenj dhe kur bëhen tok, bëjnë një det...

Popujt dinë të dallojnë

Ndërsa drama “Një dashuri Ballkanasë...” e ka shkruar në kujtim të çlirimtarëve të Kosovës, tregon për një shqiptar të plagosur të UÇK-së, që edhe pse i shtruan në spital, nuk bindet të zbatojë urdhërin për dorëzimin e armës... ai shtërngon fortë automatikun dhe ju thotë “Të vdekur mund t’ma merrni, por të gjallë, besa, kurrë”.

Azem Krasniqi kishte mbajtur ditar qysh kur ishte adoleshent. E tashti që kam ardhë në radhët e UÇK-së nuk kam hequr dorë... Nuk i dihet, se edhe mund të vritej. Dhuna serbe i ka detyruar të rrëmbenin armët... Madje edhe mua, që dikur besoja në mirëkuptim e mjeteve paqësore... Në radhët e UÇK-së kam ardhë vonë... tepër vonë... pasi më vranë vajzën që dashuroja... Një vajzë, që e donte botën, por e urrenin të vetët... Një vajzë, që po t’ju them emrin, do më urrejnë të mitë. Megjithatë, ne nuk pyetem... u dashuruam... U dashuruam deri në vdekje. Po, po, deri në vdekje. E pabesueshme, por e vërtetë. Dhe ja se si... Në shtëpinë e Brankos, ku po bënte roje një ushtar i armatosur serb, dëgjohen këngë, trokitje gotash e urime me zë të lartë. Në odën kosovare, Azemi korrigjon detyrat me shkrim të nxënësve. Më tej gjatë zhvillimit të luftës në Kosovë, Branko shoku i Azemit, por që ishte serb dhe të rritur së bashku ngre pushkën dhe vret ata që dje i kishin dhënë buk dhe e kishin shok të djalit të tyre Azem... Azem, të pastë baba, në ardhsh i gjallë, mbahu si burrat! Nëna dhe motra gjenden të therura para meje... ndërsa babai në çastet e fundit... Të gjitha këto i kemi prej Brankos... Na ka ardhur keq dhe për Ljubën... Në këtë shishe kam mbledhur gjakun tonë. Ti, Azem e di zakonisht “kur të nis me zie gjaku në shishe, na marr hakun tonë dhe të Ljubës”. Prindrit e Azemit nuk kanë varr, ata i dogjën brenda në shtëpi, pasi i masakruan... Fëmija që ke në duar është i Brankos, por ai nuk ka faj... Me Brankon bëj çdo duash i flet me përgjërime Sofia. Brankon e ke në Mitrovicë. Atje janë mbledhur të gjithë të paudhët... Dhe Azemi i duhej të ardhmes së Kosovës. Jeta e tij ishte dëshmi e dashurisë, miqësisë dhe e mirëkuptimit etnik... Këtë kërkonte kur u ngrit në luftë. Lufta që u bë nuk çliroi vetëm Kosovë, por edhe Europën nga mentalitete e së kaluarës. Çlirimi i kosovës është Rilindja e Europës së Re Humane, dhe Azemi në këtë ditë kaq të madhe nuk mund të harrojë përse kishte luftuar. Dhe Trimi Azem Karsniqi nuk vret, por di të falë...



rebel të paarmatosur dhe të pa zot... kurse gjenerali kishte 20.000 ushtarë me armë moderne të kohës, topa, flotë luftarake, aeroplanë dhe 12 gjeneralë. Ndërsa në Kaninën e Ismail Qemalit, gjeneralin në orën që rrebelet prisin përgjigje, filloi ndërtimin e vilës së tij, pranë kalasë... Sipas tij kjo ishte përgjigja më e denjë...

Gjenerali nuk dinte se sulmet shq-

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatët për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakulteti e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojnë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatoke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të



mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

Shenim: Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularët përkatës janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



QPR rekruton kandidatë për studime

Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar.
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

